



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit-Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) më datën 28.05.2014 realizoi vizitë pasuese në SP-Bit Pazar e cila kishte për qëllim ta kontrollojë implementimit e rekomandimeve të dhëna në raportin nga vizita e rregullt e realizuar më datën 09.12.2011.

MPN realizoi **vizitë të paparalajmëruar pasuese** në Stacionin policor-Bit Pazar në suaza të mandatit dhe kompetencave të cilat rezultojnë nga Protokolli Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe Ligjit për Avokatin e Popullit. Vizita u fokusua në disa konstatime negative nga raporti i veçantë i vitit 2011 dhe vlerësimin e implementimit të rekomandimeve të dhëna.

Vizita pasuese e Stacionit policor-Bit Pazar u realizua në disa hapa. Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional në fillim sqaroi qëllimin e vizitës pasuese pranë përgjegjësit të turnit të stacionit policor, ndërkaq, mëtej realizoi inspektim në ambientet për ndalim, hapsirat për bisedë dhe pranim, tualetët për personat e ndaluar, si dhe inspektim në Librin për ngjarjet ditore, Regjistrin për persona të privuar nga liria, Regjistrin për përdorimin e mjeteve për detyrim dhe gjashtë dosarët ndihmës për persona të ndaluar. MPN gjatë vizitës realizoi bisedë me person të arrestuar për trajtimin dhe realizimin e të drejtave në procedurë policore.

Nga vizita pasuese të cilën e realizoi Mekanizmi Parandalues Nacional u konstatua se numri më i madh i rekomandimeve të cilat kanë të bëjnë me Stacionin policor-Bit Pazar ishin implementuar, ndërsa rekomandimet të cilat janë në lidhje me ministrinë kompetente (MPB) mbeten të parealizuara.

MPN konstatoi se nga tualetët akoma nuk ishin larguar materialet e rrezikshme dhe sendet. MPN konsideron se sendet e njëjta duhet të largohet me qëllim që personi i ndaluar mos të vetlëndohet ose mos t'u shkaktojë lëndime zyrtarëve policorë. Njëherazi u konstatua se ambientet për marrje në pyetje dhe bisedë me personat e privuar nga liria edhe pse janë vënë në funksion, akoma nuk janë pajisur në mënyrë përkatëse me kompjuter dhe pajisje tjera teknike.

Nga ana e nëpunësit policor ishte dhënë informatë se personat e privuar nga liria nuk futen nga hyrja e pasme sepse e njëjta nuk është e qasshme. Sa i përket ushqimit ishte theksuar se SP Bit Pazar akoma nuk disponon me mjete përkatëse financiare për furnizim me ushqim.

Edhe pse në një pjesë të rekomandimeve të dhëna MPN konstatoi progres, përkatësisht implementimin e tyre nga ana e SP-Bit Pazar, në mënyrë plotësuese gjatë vizitës pasuese u vërejt se, në dokumentacionin e personave të ndaluar nuk ka rrjedhë logjike të ngjarjeve, përkatësisht ishte shënuar kohë e njëjtë për arrestim, ndalim si dhe udhëzim për të drejtat e personit të privuar nga liria. Në këtë drejtim MPN konsideron se është e nevojshme që evidentimi të bëhet në mënyrë të plotë për persona të cilët janë arrestuar, privuar nga liria dhe të ndaluar në stacionin policor, duke pasur kujdes për rrjedhën logjike të ngjarjeve, prej kohës së privimit nga liria deri në kohën e ndalimit në stacionin policor sa i përket respektimit të kohës maksimale të privimit prej 24 orë për person të rritur dhe 12 orë për person të mitur.

Gjatë kohës së vizitës në Stacioni policor-Bit Pazar kishte një person të arrestuar. Ekipi i MPN-së me personin e njëjtë realizoi bisedë e cila ishte e natyrës konfidenciale dhe pa praninë e personave zyrtarë. Sipas informatave të pranuar nga vet personi, në momentin e privimit nga liria zyrtarët policorë janë sjellur në mënyrë korrekte, personi ishte udhëzuar për të drejtat e tij në procedurë policore, siç është e drejta për mjek, e drejta për mbrojtës, si dhe e drejta për ta njoftuar personin e familjes.

Si rezultat i vizitës së realizuar Avokati i Popullit si Mekanizëm parandalues Nacional hartoi raportin e veçantë për vizitën pasuese gjatë të cilës konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse adresuar pranë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pranë kryeshefit të Stacionit Policor-Bit Pazar me qëllim të eliminimit të mangësive të detektuara.